

GJYKATA E QARKUT, PRISHTINË

KA 505/11
GJPP 25/10
PPS 07/10

E datuar më 26 gusht 2011

Gjyqtari për konfirmim nga EULEX-I Ingo RISCH, në lëndën penale kundër:

1. A. K.,

, I arrestuar ne Zvicër më 16 mars 2011, për arsye të ekstradimit, dhe në arrest shtëpiak që nga 14/ prill/2011, i akuzuar për: **Krime të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Robërve të Luftës**, sipas Neneve 142, 144 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), gjithashtu i paraparë në Nenet 120, 121, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), i lexuar ne lidhje me Nenet 22, 24, dhe 26 të KPRSFJ dhe 23, 25, dhe 26 të KPK, në shkelje të Nenit të përbashkët Nenit 3 të të katër Konventave të Gjenevës 1949, dhe Neneve, 4, 5(1) të Protokollit II shtesë në të katër Konventat e Zhenevës(PSHII); dhe me **dy (2) Akuza për Krime të luftës kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët Nenit 3 e të katër Konventave të Zhenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) PSHII;

2. N. K.

, në paraburgim që nga 16 marsi 2011; i akuzuar për; **Krime të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të përbashkët Nenit 3 të të katër Konventave të Gjenevës 1949, dhe Neneve, 4, 5(1) të PSHII; i akuzuar me **katër (4) Akuza për Krime të luftës kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët Nenit 3 e të katër Konventave të Zhenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) PSHII;

3. N. K.,

, Në paraburgim që nga data 16 mars 2011; i akuzuar për **Krime të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të përbashkët Nenit 3 të të katër Konventave të Zhenevës 1949, dhe Neneve, 4, 5(1) të PSHII; i akuzuar me **pesë (5) Akuza për Krime të luftës kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët Nenit 3 e të katër Konventave të Gjenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; për **Krime të Luftës kundër Popullatës Civile**, sipas Neneve 22, 142, të KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve

23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të përbashkët Nenit 3 të të katër Konventave të Gjenevës 1949, dhe Neneve, 4, 5(1) të PSHII;

4. **B. L.**,

, Nën arrestin shtëpiak që nga data 16 mars 2011; i akuzuar për *Krime të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Robërve të Luftës*, sipas Neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ, i penalizuar sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të përbashkët Nenit 3 të të katër Konventave të Zhenevës 1949, dhe Neneve, 4, 5(1) të PSHII; i akuzuar me *Akuza për Krime të luftës kundër Robërve të Luftës*, sipas Neneve 22, 144 KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët Nenit 3 e të katër Konventave të Zhenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; ,

5. **F. L.**,

; i akuzuar për *Krime të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Robërve të Luftës*, sipas Neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të përbashkët Nenit 3 të të katër Konventave të Gjenevës 1949, dhe Neneve, 4, 5(1) të PSHII; dhe i akuzuar me *dy (2) Akuza për Krime të luftës kundër Robërve të Luftës*, sipas Neneve 22, 144 KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët Nenit 3 e të katër Konventave të Gjenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; ,

6. **R. M.**,

, në paraburgim që nga data 16 mars 2011 e deri më 11 qershor 2011 dhe pastaj nën arrest shtëpiak që nga 11 qershor 2011; i akuzuar për *Krime të Luftës kundër Popullatës Civile*, sipas Neneve 22, 142, të KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të përbashkët Nenit 3 të të katër Konventave të Gjenevës 1949, dhe Neneve, 4, 5(1) të PSHII; i akuzuar për *Krime të luftës kundër Robërve të Luftës*, sipas Neneve 22, 144 KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët Nenit 3 e të katër Konventave të Gjenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; ,

7. **N. SH.** ,

, në paraburgim që nga 16 marsi 2011; i akuzuar për *Krime të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Robërve të Luftës*, sipas Neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të përbashkët Nenit 3 të të katër Konventave të Gjenevës 1949, dhe Neneve, 4, 5(1) të PSHII; i akuzuar me *katër (4) Akuza për Krime të luftës kundër Robërve të Luftës*, sipas Neneve 22, 144 KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët Nenit 3 e të katër Konventave të Gjenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; për *Krime të Luftës kundër Popullatës Civile*, sipas Neneve 22, 142, të KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të përbashkët Nenit 3 të të katër Konventave të Gjenevës 1949, dhe Neneve, 4, 5(1) të PSHII;

8. **S. SH.**,

në paraburgim që nga 16 marsi 2011 i akuzuar për *Krime të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Robërve të Luftës*, sipas Neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të përbashkët Nenit 3 të të katër Konventave të Gjenevës 1949, dhe Neneve, 4, 5(1) të PSHII; i akuzuar për *Krime të luftës kundër Robërve të Luftës*, sipas Neneve 22, 144 KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët Nenit 3 e të katër Konventave të Gjenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; ,

9. **Sh. SH.**,

; i
arrestuar më 16 mars 2011 dhe që atëherë nën masat e paraqitjes pranë stacionit Policor i akuzuar për *Krime të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Robërve të Luftës*, sipas Neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të përbashkët Nenit 3 të të katër Konventave të Gjenevës 1949, dhe Neneve, 4, 5(1) të PSHII;

10. **B. SH.**,

, nën arrestin shtëpiak që nga data 16 mars 2011; i akuzuar për *Krime të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Robërve të Luftës* sipas Neneve 22, 142, të KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të përbashkët Nenit 3 të të katër Konventave të Gjenevës 1949, dhe Neneve, 4, 5(1) të PSHII; i akuzuar për *Krime të luftës kundër Robërve të Luftës*, sipas Neneve 22, 144 KPRSFJ, të penalizuara sipas Neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët Nenit 3 e të katër Konventave të Gjenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; ,

Pas seancës së konfirmimit të aktakuzës të mbajtur më 24 dhe 25 gusht 2011, në praninë e të pandehurve dhe Avokatëve të tyre:

A. K., Avokati i tij i Mbrojtjes Fehmije Gashi-Bytyqi,
N. K., Avokati i tij i Mbrojtjes Florin Vertopi dhe Xhafer Maliqi,
N. K., Avokati i tij i Mbrojtjes Mahmut Halimi,
B. L., Avokati i tij i Mbrojtjes Ramiz Krasniqi,
F. L., Avokati i tij i Mbrojtjes Tomë Gashi dhe Klaus E. Kirchner,
R. M., Avokati i tij i Mbrojtjes Haxhi Millaku,
N. SH., Avokati i tij i Mbrojtjes Bajram Tmava,
S. SH., Avokati i tij i Mbrojtjes Mexhid Sylja,
Sh. SH., Avokati i tij i Mbrojtjes Destan Rukiqi,
B. SH., Avokati i tij i Mbrojtjes Fazli Balaj,

Dhe gjithashtu me pjesëmarrjen e Prokurorit Maurizio SALUSTRO nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës;

Duke u mbështetur në Nenin 316 Par. 4 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshon si në vijim:

AKTVENDIM

Konfirmohet aktakuza e Prokurorisë Speciale në Prishtinë PPS nr. 07/2010, e datës 25 korrik 2011.

Aktakuza, së bashku me të gjitha të dhënat e shkresave të lëndës, do t'i dërgohen Kryetarit të Trupit Gjykses për shqyrtimin kryesor, menjëherë pasi ky vendim të bëhet i formës së prerë.

Arsyetimi

I. Hyrje

Më 25 korrik 2011, Prokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës ka paraqitur në gjykatë Aktakuzën PPS nr. 07/2010, të datës 25 korrik 2011.

Aktpadia akuzon të pandehurit për veprat penale përkatëse të pretenduara si të kryera nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit 1999 kundër civilëve Serbë dhe Shqiptarë dhe të burgosurve ushtarak serbe dhe oficerëve të policisë të mbajtur të mbyllur në qendrën e paraburgimit të improvizuar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) e vendosur në fshatin Kleçkë / . Pretendimet e bëra në Aktakuzë mbështesin akuzat e ndryshme kundër të pandehurve për shkelje të ligjeve dhe rregullave të luftës.

Pas ngritjes së Aktakuzës, Gjyqtari për konfirmim e ka vlerësuar Aktakuzën në pajtim me Nenin 306 Par. 2 të KPPK.

Sa i përket kundërshtimeve të Avokatëve Mbrojtës në lidhje me kërkesat e përshkruara në Nenin 305 Par. 1 Nën-par. 4 dhe 5 të KPPK, për përmbajtjen e Aktakuzës, Gjyqtari për konfirmim konstaton si në vijim:

Në lidhje me Nenin 305 Par. 1 Nën-par. 4 të KPPK:

- Koha (në fillim të vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999) dhe vendi (fshati Kleçkë) i kryerjes së veprave penale në lidhje me të gjitha pikat e Aktakuzës janë të treguara;
- Objekti mbi të cilin janë kryer veprat penale janë të përshkruara në lidhje të qartë për viktimat përkatëse (të burgosurit të treguar në aktakuzë);
- Instrumentet me të cilat janë kryer veprat penale (zinxhirët, pushkët automatike, pistoletat, kosa dhe me rrahje);
- Rrethanat e tjera të sakta janë përshkruar gjithashtu, si rolet, strukturat, çështjet e hierarkisë, etj.

Në lidhje me nenin 305 par. 1 Nën-par. 5 i KPPK:

- Shpjegimi i arsyeve për ngritjen e aktakuzës, si rezultat i hetimit janë të përshkruara;
- Provat që përcaktojnë faktet kyçe gjithashtu janë të përmendura qartë.

Prandaj Gjyqtari për konfirmim është i kënaqur që Aktakuza është e përpiluar në përputhje me nenin 305 të KPPK.

Përveç kësaj, sipas nenit 306 par. 3 të KPPK, Gjyqtari për konfirmim konstaton se aktakuza nuk përmban prova të papranueshme apo referenca për prova të tilla.

Si pasojë Gjyqtari për konfirmim ka caktuar seancën e konfirmimit më 24 dhe 25 gusht 2011 (dhe gjithashtu fillimisht më 26 gusht 2011) në pajtim me nenin 309 par. 2 të KPPK-së.

Në seancë të gjithë të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e Aktakuzës kundër tyre.

II. Çështjet procedurale

Fillimisht gjatë seancës së konfirmimit Avokatët Mbrojtës kanë ngritur çështjen e Nenit 307 të KPPK-së, në lidhje me detyrimin e prokurorit që ti bëjë të ditura provat. Ankesa kryesore ishte se prokurori nuk e ka pajisur Mbrojtjen me aktvendimin për fillimin e hetimeve, shtrirjen e hetimeve të bërë nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake dhe zgjerimin kundër të pandehurve të tjerë, dhe për këtë arsye ata nuk mund të vlerësojnë nëse provat ishin mbledhur në kuadër të afatit kohor të hetimit.

Ankesa e mëtejshme e mbrojtjes ishte në lidhje me deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues X. Mbrojtja mori versionet e redaktuara nga deklaratat dhe për këtë arsye ishte e parandaluar për të parë disa pjesë të deklaratave. Gjithashtu ata nuk kishin marrë deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues X dhënë hetuesve të Tribunalit të Hagës.

Një tjetër ankesë është në lidhje me zhvarrosjen e kufomave dhe raportet e autopsisë. Mbrojtja ka ngritur çështjen se a është kryer zhvarrosja në bazë të një urdhërese të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake dhe gjithashtu se raporti i autopsisë ishte vetëm në gjuhën angleze.

Gjatë seancës së konfirmimit prokurori ka pajisur Avokatët Mbrojtës me vendimet për fillimin e hetimit, shtrirjen e hetimit dhe zgjerimin e hetimit, me redaktimet e emrave të cilat nuk duhet të zbulohen. Gjithashtu CD-ja që përmban deklaratën e dëshmitarit bashkëpunues X dhënë hetuesve të Tribunalit të Hagës i është dhënë Avokatëve Mbrojtës. Në lidhje me këtë CD, prokurori deklaroi se ai nuk ka marrë njoftim për përmbajtjen e CD-së dhe se ajo nuk është përdorur për paraqitjen e Aktakuzës.

Më tej, sa i përket redaktimit të pjesëve të deklaratave të dëshmitarit bashkëpunues X, prokurori deklaroi se ai ka vepruar në përputhje me urdhëresën e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake të datë 25 gusht 2010. Kjo urdhëresë parasheh që duhet të redaktohen të gjitha pjesët e deklaratës, të cilat mund të çojnë në zbulimin e identitetit të dëshmitarit bashkëpunues

X.

Gjyqtari për konfirmim i ka vlerësuar të gjitha dokumentet përkatëse për këto çështje dhe konstaton se hetimi ka filluar më 02 shkurt 2010. Të gjitha provat e mbledhura gjatë hetimit janë mbledhur brenda afatit të hetimit.

Lidhur me zhvarrosjen e kufomave dhe raportet e autopsisë, Gjyqtari për konfirmim konstaton se urdhërat për të kryer zhvarrosjen janë lëshuar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës. Në fakt, raportet janë vetëm në gjuhën Angleze. Megjithatë, çështja se këto raporte janë në gjuhën Angleze nuk mund të çojnë në papranueshmëri. Raportet në gjuhën Shqipe do ti jepen Mbrojtjen para shqyrtimit gjyqësor.

Në lidhje me pyetjen nëse Avokatët Mbrojtës ishin të pajisur me kohë me dokumentet e përmendura në Nenin 307 të KPPK, Gjyqtari për konfirmim i referohet shpjegimit të prokurorit publik, i cili kishte ftuar Avokatët Mbrojtës për të mbledhur dokumentet e listuara. Për më tepër prokurori publik pretendon se nuk është i detyruar për ti siguruar Avokatët Mbrojtës me ato dokumente të cilat nuk janë të përmendura në Nenin 307 të KPPK.

Megjithatë, sipas shpjegimit të prokurorit, Avokatët Mbrojtës nuk i janë qasur prokurorisë, dhe për këtë arsye Gjyqtari për konfirmim e sheh të arsyeshme se prokuroria gjatë seancës së konfirmimit e ka pajisur Mbrojtjen me dokumentet që kanë munguar dhe në veçanti nuk e shohin nevojën për shtyrjen .

Sa i përket redaktimit të pjesëve të dokumenteve të caktuara, Gjyqtari për konfirmim ka vlerësuar nevojën e redaktimeve dhe e ka justifikuar atë për arsye të sigurisë së dëshmitarëve dhe për të siguruar përfundimin e suksesshëm të hetimit të mëtejshëm.

III. Konsiderimet në vlerësimin e Aktakuzës

Në fazën e tanishme të procedurës penale, Gjyqtari për konfirmim duhet të përcaktojë nëse ka apo nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale sikurse të prezantuara në Aktakuzë (Neni 316 Par. 1 Nën-par. 4 të KPPK).

Standardi që duhet të plotësohet për të konfirmuar Aktakuzën është ai i dyshimit të bazuar mirë. Prandaj, nuk është çështje për Gjyqtarin për konfirmim që në fazën e tanishme të procedurave të shqyrtoj veç e veç secilën pjesë të provave që të përcaktoj fajin apo pafajësinë e secilit nga të pandehurit. Kjo nuk është detyrë që duhet të kryhet në konfirmimin e aktakuzës dhe se kjo duhet të ngelet për në fazën procedurës së shqyrtimit gjyqësor kryesor.

Rrjedhimisht, duhet të ketë prova të mjaftueshme për të lejuar përfundimin se është më se e mundshme që të pandehurit i kanë kryer veprat penale përkatëse.

IV. Vlerësimi i një dyshimi të bazuar mirë

Gjyqtari për konfirmim nuk ka gjetur asnjë arsye për të shkarkuar Aktakuzën, sipas Nenit 316 Par. 1 dhe 2, duke pasur parasysh se aktet kriminale të përmendura në Aktakuzë janë vepra penale, dhe se nuk ka asnjë rrethanë që të përjashtoj përgjegjësinë penale; dhe se kufizimet ligjore nuk kanë mbaruar, që padia është ngritur nga një prokuror i autorizuar; se nuk ka rrethana të që ta përjashtoj prokurorinë; dhe se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale të përmendura në Aktakuzë.

Një "dyshimi i bazuar" mund të përkufizohet si "*ekzistenca e fakteve apo të dhënave që do të kënaqë një vëzhgues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer veprën penale*" - (ECHR, Fox, Cmbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, 30 gusht 1990, Par. 32). Një "dyshimi i bazuar-mirë" kërkon siguri më shumë se një dyshim i bazuar - pa arritur në pragun e faktit të provuar.

Gjyqtari për konfirmim konstaton, sipas dosjes së lëndës dhe të provave që gjinden në të, se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur "dyshimin e bazuar-mirë" në lidhje me të gjitha akuzat në Aktakuzë, dhe e sjell aktvendimin aktual në pajtim me Nenin 316 par. 4 të KPPK.

Dyshimi i bazuar-mirë për të gjitha akuzat dhe për të gjithë të pandehurit në aktakuzë është ngritur kryesisht nga deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues X. Deklaratat e tija janë të mbështetura nga pjesë të tjera të provave, të paktën si deklaratat e dëshmitarëve A, C, H, I, M. Deklarata e dëshmitarit bashkëpunues X. është mbështetur edhe nga zhvarrosja dhe raportet e autopsisë dhe ekzaminimit post mortem të kufomave të gjetura në vendet ku viktimat ishin varrosur, siç është përshkruar paraprakisht nga dëshmitari bashkëpunues X. Për më tepër dëshmitari bashkëpunues X ka dhënë deklarata shpjeguese në lidhje me metodën dhe mënyrën në të cilën viktimat u vranë.

V. Detyrimet e Gjyqtarit për Konfirmim

Është detyrë e Gjyqtarit për konfirmim që të merr vendim për pyetjet, nëse

- Aktpadia është përpunuar konform Nenit 305 të KPPK, në veçanti të mos përmbajë kontradikta, dhe për shembull, akuza të cilat nuk janë të mbështetura me dëshmi;
- Statusi i dyshimit të bazuar-mirë është arritur me dëshmi të mjaftueshme;
- Dhe provat e papranueshme.

Nuk është detyrë e Gjyqtarit për konfirmim për të marrë në pyetje dëshmitarët ose pjesë të tjera të provave (shih Nenin 314 Par. 6 të KPPK).

Prandaj Gjyqtari për konfirmim mund të përmbushë vetëm ekzaminimin paraprak dhe rrjedhimisht çështja e besueshmërisë ose jo-besueshmërisë së një dëshmitari është një çështje e Trupit Gjykyes në shqyrtimin kryesor, sepse Gjyqtari për Konfirmim nuk ka të drejtë për të parë e as për të intervistuar një dëshmitar.

Për këtë arsye Gjyqtari për Konfirmim mundet vetëm të vlerësojë se nëse provat e mbledhura

gjatë hetimit ish in të ligjshme. Lidhur me dëshmitarin bashkëpunues, në këtë fazë të procedimit Gjyqtari për konfirmim është i detyruar që të vlerësoj nëse është respektuar procedura e shpalljes së një personi si dëshmitar bashkëpunues, apo me dëshmitarin anonim.

Në rastin konkret Gjyqtari për konfirmim konstaton se procedura është respektuar plotësisht ashtu siç është e paraparë në Kapitullin XXXI të KPPK në lidhje me dëshmitarët bashkëpunues dhe Kapitullin XXI të KPPK në lidhje me dëshmitarët anonim.

Në veçanti sipas Nenit 300 par. 5 të KPPK, dëshmitari bashkëpunues X, përkundrazi me mendimin e Avokatëve Mbrojtës, nuk mund të shihet si një organizator apo udhëheqës i grupit kriminal, pasi ky përkufizim i referohet kriminit të organizuar dhe dëshmitari bashkëpunues X nuk i përmbush kërkesat për të qenë një organizator apo udhëheqës i grupit të personave që kryen vepra penale.

VI. Parashtrësat e Mbrojtjes

Sa i përket çështjes së ngritur nga Mbrojtja për mjaftueshmërinë e provave, e cila është bazuar kryesisht në deklaratën e një dëshmitari bashkëpunues, çon në çështjen e interpretimit të Nenit 157 par. 4 të KPPK.

Në lëndën aktuale provat nuk janë të bazuara **vetëm** në dëshminë e dhënë nga dëshmitari bashkëpunues, edhe pse dëshmitari bashkëpunues X mund të shihet si dëshmitari kyç. Për më tepër, Neni 157 Par. 4 i KPPK - duke marrë parasysh faktin se çështja e provës së vetme mund të vërtetohet - kjo i adresohet Trupit Gjykues në shqyrtimin kryesorë dhe e kufizon Gjykatën për ta konstatuar dikë si fajtor. Megjithatë, siç u përmend më sipër, Gjyqtari për konfirmim nuk jep një përgjigje për pyetjen e fajit, por, me anë të ekzaminimit paraprak të tij, por vetëm një përgjigje për mjaftueshmërinë e dyshimit të bazuar-mirë dhe çështjen e pranueshmërisë së provave.

Në lidhje me ankesën e Mbrojtjes në lidhje me pranueshmërinë e deklaratave të dhëna nga dëshmitari bashkëpunues X para se ai të shpallej dëshmitar bashkëpunues, derisa ai ishte i dyshuar /i pandehur, - është theksuar se kjo është një çështje e kredibilitetit dhe përgjegjësisë së dëshmitarit bashkëpunues. Detyra për të vlerësuar besueshmërinë dhe përgjegjësinë është e Trupit Gjykues në shqyrtimit kryesor dhe jo e Gjyqtarit për konfirmim.

Më tej, Mbrojtja është ankuar për detyrimet e prokurorit për të dhënë detaje specifike në lidhje me veprat penale të secilit prej të pandehurve dhe për çdo akuzë. Në konkretisht, mbrojtja pretendoi se Aktakuza përmban vetëm pjesë kopjo dhe bashka-ngjit (copy-paste) të akuzave dhe në mënyrë të tillë janë përdorur për të pandehurit, dhe në shkallë të madhe ka humbur individualizimin e kontributit të veçantë për akuzat në fjalë. Në këtë drejtim duhet theksuar se akuzat përbëhen nga veprat penale të cilat thuhet se janë kryer në bashkëpunim dhe për këtë arsye është e mjaftueshme për ti përshkruar se bashkë-autorët kishin qëllim për të kryer veprat penale dhe për të kontribuar në rezultimin e kriminit. Me fjalë të tjera, në qoftë se dy njerëz dëshirojnë të vrasin një person, dhe ata e bëjnë këtë, prokurori dhe gjykata nuk janë të

detyruara që të japin një përshkrimin e saktë se kush e tërhoqi këmbëzën, nëse kjo ngelet si një çështje e hapur.

Në lidhje me trajtimin çnjerëzor në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, Aktakuza përshkruan qartë kushtet (të burgosurit e lidhur me zinxhirë, ambientet e papërshtatshme, të ftohtë e tepruar, mungesa e përmbushjes së nevojave higjienike, të ushqyerit e papërshtatshme, dhe rrahjeve të shpeshta), dhe gjithashtu është përshkruar roli i secilit të pandehur. Prandaj pohimi i dhënë nga Avokati Mbrojtës Fazli Balaj, i cili ngriti pyetjen se nëse dikush kryen një veprë penale të krimeve të luftës *duke i dhënë një shuplakë* një të burgosur të luftës, mund të shihet vetëm si një përpjekje për të trivializuar akuzën.

Në lidhje me parashtresat e Avokatëve Mbrojtës për çështjen që Aktakuza përmban disa akuza të krimeve të luftës për secilin nga të akuzuarit (me përjashtim të vetëm që i pandehuri numër 9 është i ngarkuar vetëm me një pikë), Gjyqtari për konfirmim konstaton se secila akuzë në Aktpadi është në lidhje me akte të ndryshme kriminale dhe - përsëri – Gjyqtari për konfirmim konstaton se në lidhje me secilën nga këto akuza ka prova të mjaftueshme për të ardhur në përfundim të një dyshim të bazuar-mirë.

VII. Papranueshmëria / pranueshmëria e provave

Përveç ankesave të mbrojtjes, Gjyqtari për konfirmim sipas detyrës zyrtare ka vlerësuar çështjen e papranueshmërisë së provave dhe konstaton se të gjitha provat e paraqitura nga prokurori publik janë të pranueshme. Sipas Nenit 153 Par. 1 të KPPK, pjesët e provave mund të shpallen si të papranueshme, kur ato janë marrë në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale. Veçanërisht në këtë lëndë nuk ka asnjë dispozitë e cila shprehimisht përcakton papranueshmërinë, si për shembull shkelja e Neneve 161, 246, 254 Par. 2 i KPPK.

Prandaj vendoset si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform Nenit 316 Par. 4 të KPPK.

Gjykata e Qarkut, Prishtinë
KA 505/11 26 gusht 2011

Gjyqtari për konfirmim

Ingo Rish
Gjyqtari i EULEX-it

